



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 25, datë 11.06.2025

PËR MBARIMIN PËRPARA AFATIT TË MANDATIT TË KËSHILLTARIT
Z.ANI DYRMISHI

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e Ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 47, pika 1, gërma “ç”, neni 49, pika 4, gërma “b”, “c”, pika 5, neni 54, pika “j”, neni 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funksionimit të Këshillit Bashkisë Durrës, mbështetur në raportin e Komisionit të Mandateve, në mbledhjen e radhës së datës 11.06.2025,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Mbarimin para afatit të mandatit të këshilltarit të Këshillit Bashkiak Durrës, z. Ani Luan Dyrmishi, për shkak të dorëheqjes dhe se merr një funksion të papajtueshëm me funksionin e Këshilltarit, kandidat nga lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.
2. Të shpall vakancën për në Këshillin Bashkiak.
3. Për këtë vendim të njoftojë Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.
4. Ngarkohet Sekretari Këshillit Bashkiak, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës


Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 12.06.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 339/15 prot.

Durrës, më 16 . 06.2025

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.25 datë 11.06.2025 ,” Për mbarimin përpara afatit të mandatit të këshilltarit Z.Ani Dyrmishi”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

